



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT**

V E N D I M

Nr. 03, datë 23.10.2025

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “SHITESË KATI 1 KAT DHE
SHITESË ANËSORE 2 KATE PËR OBJEKTIN EKZISTUES 2 KATE DHE 1 KAT
NËNTOKË, ME FUNKSION PUNISHTË”, NDODHUR NË LUNDËR, NJËSIA
ADMINISTRATIVE FARKË, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “AV 7” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Shtesë kati 1 kat dhe shtesë anësore 2 kate për objektin ekzistues 2 kate dhe 1 kat nëntokë, me funksion punishte”, ndodhur në Lundër, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “AV 7” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

ENEA KARAKAÇI



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 26/05 / 2026